**VENDIM**

**Nr. ____, datë ___**

**MBI KRITERET E PËRDORIMIT TË PROCEDURËS SË THJESHTËZUAR TË FISKALIZIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 22 dhe të pikës 1 të nenit 27 të ligjit nr.___, datë___ "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomise, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

**1.** Tatimpaguesit që lëshojnë fatura për transaksione me para në dorë, që sipas nenit 22 të Ligjit nr. ____, datë ____ "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" mund të lëshojnë fatura dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit përmes përdorimit të platformës qendrore të faturave, nëse përmbushin të katër kriteret e mëposhtme:

a) nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar;

b) nuk kanë asnjë shkelje të konstatuar në lidhje me mos-lëshimin e kuponit tatimor/faturës në 3 vitet e fundit;

c) nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

d) nuk lëshojnë më shumë se 350 kupona tatimorë apo/edhe fatura gjatë një viti fiskal.

**2.** Tatimpaguesit që lëshojnë fatura elektronike për transaksione pa para në dorë, që sipas nenit 27 të ligjit nr. ___, datë ___ "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" mund të lëshojnë fatura elektronike dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit përmes përdorimit të platformës qendrore të shkëmbimit të faturave, nëse përmbushin të dy kriteret e mëposhtme:

a) nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar;

b) nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

c) nuk kanë asnjë shkelje të konstatuar në lidhje me mos-lëshimin e kuponit tatimor/faturës në 3 vitet e fundit;

d) nuk lëshojnë më shumë se 350 kupona tatimorë apo/edhe fatura gjatë një viti fiskal.

**3.** Tatimpaguesi që lëshon fatura sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, mund të përdorë platformën qendrore të faturave për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, për sa kohë që përmbush të gjitha kriteret e kërkuara. Në momentin kur një nga kriteret nuk përmbushet më

prej tatimpaguesit, tatimpaguesi nuk mund të përdorë më tej platformën qendrore të faturave për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, por duhet të zbatojë procedurën e fiskalizimit me anë të zgjidhjeve softuerike të certifikuara, sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara në ligjin nr. ____, datë ___ "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit".

Përjashtimisht në rastet e mos-përmbushjes së kriterit në pikën b të nenit 1 dhe 2 më sipër, tatimpaguesi ka 30 ditë afat të zbatojë procedurën e fiskalizimit me anë të zgjidhjeve softuerike të certifikuara, sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara në ligjin nr. ___, datë ____ "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit".

**4.** Procedurat, afatet dhe çështjet e tjera që lidhen me përdorimin e platformës qendrore të faturave dhe lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, në bazë të këtij vendimi, rregullohen me udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. ___, datë ___ “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.